



Pranuar / Dorezuar Priljepleni/Prodato Received/Delivered	01.11.2023	3	vit god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKLIMSHKIL	6808/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1171/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1171/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesja

[redacted] kundër Vendimit me numër Nr.198/2023 të datës 08.09.2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1171/2023 e datës 18.09.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

Arsyetim

Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 34 paragrafi (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës fillimisht më datë 14.07.2023 ka njoftuar për konkursin me numër reference Nr.ref.RN00012073, për grupin "Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm" për pozitën e punës „Inspektor i Tregut në Prishtinë“, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ku afati për aplikim ka qenë nga data 04.08.2023 deri më datën 11.08.2023.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me kodin Nr. RAN0017185. Më datë 08.09.2023 Divizioni për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.198/2023 përmes së cilit i ka refuzuar aplikacionin ankueses, me arsyetimin se e njëjta nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara sipas konkursit, nëse përvoja e punës e deklaruar në sektorin privat në OJQ apo ndonjë angazhim tjetër prej nga rrjedhë edhe marrëdhënia e punës, ka qenë i nevojshëm vet deklarimi i nënshkruar se ajo nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Më datë 12.09.2023 ankuesja kundër këtij Vendimi, ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa më datë 19.09.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendim me numër Nr.14/2023 përmes së cilit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër Nr.14/2023 të datës 12.09.2023 të Divizionit për Zhvillim të Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 18.09.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6135/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së parimeve të Ligjit kundër Diskriminimit dhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik. Ndërsa Këshilli me datë 26.09.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6135/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference nr.RN00012073 të datës 04.08.2023; Vendimin me numër Nr.198/2023 të datës 08.09.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 26.09.2023; Listën e aplikantëve me numër reference Nr.RN00012073; Njoftimin e datës 11.09.2023; Njoftimin e datës 19.09.2023; Ankesën e datës 12.09.2023; Vendimin me numër Nr.14/2023 të datës 19.09.2023; Aplikacionin e datës 11.08.2023; Diplomë me numër protokollit nr.71 i datës 24.06.1993; Diplomë me numër nr.170/12 e datës 15.10.2012; Diplomë me Nr.22/22 e datës 06.06.2022; Certifikatë e datës 22.05.2001; Certifikatë për vitin 2021; Kontratë e punës e datës 02.04.2002; Pasqyra e Llogarisë së Trustit 01.08.2002 deri 03.02.2017; Listë për pagesa për vitin 2004; Referencë; Letër Reference e datës 19.11.2018; Letër reference e datës 02.03.2023; Certifikatë e datës 06.06.2000; Kopjen e letërnjoftimit; Pasqyra e Llogarisë së Trustit 01.08.2002-09.08.2023; Certifikatë mbi dënimet penale me numër Nr.ser.01C882D030AD45B e datës 11.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e parakohëshme, sepse:*

Pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër Nr.RN00012073 për emrin e grupit „Specialistë i Administrimit të Përgjithshëm“, për pozitën e punës „Inspektor i Tregut“, në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fushat; Arsim i lartë i paspecifikuar;*
- *Kualifikime të posaçme formale;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit; Kopjen e dëshmisë së punësimit të bashkangjitur së paku një dëshmi mbështetëse si në vijim: pasqyrën pagesave të fondit të kursimeve pensionale ; kopjen e licencës për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit; Dëshmi mjekësorë se kandidati është në gjendje shëndetësore për të kryer detyrat; Certifikatën /vërtetimin nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësorë i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prere për kryerjen e një veprë penale me dashje jo me të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati me të cilin dëshmohet se ai nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda apo jashtë vendit në një OJQ brenda apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës në ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetë deklaram i nënshkruar se ajo nuk ka një masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas ligjit NR.06/L për Zyrtar Publik.*

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesja dhe institucioni, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesja ka aplikuar në konkursin me numër reference Nr.RN00012073, për pozitën e punës „Inspektor i Tregut” në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e njëjta sipas Vendimit me numër Nr.198/2023 të datës 08.09.2023 është njoftuar se aplikacioni i saj i është refuzuar, e pakënaqur me Vendimin me numër Nr.198/2023 të datës 08.09.2023 të Divizionit për Zhvillim dhe Rekrutim dhe Inspektim, më datë 12.09.2023 ka parashtruar ankesë në Divizionin për Zhvillim dhe Rekrutim dhe Inspektim të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Më datë 18.09.2023 ankuesja ende pa e marrë Vendimin lidhur me ankesën e saj ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa bazuar nga shkesat e dërguara nga ana Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Divizioni për Zhvillim dhe Rekrutimin e Inspektimit më datën 19.09.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.14/2023, përmes së cilit e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesja

Mbi këtë bazë dhe në kuptim të pranueshmerisë së ankesës së ankueses, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 15 paragrafët 5, dhe 6, ku përcaktohet se: *“5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimin të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj si dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të më të cilin parashihet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimin në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrorë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet...”* dhe si rrjedhojë mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstaton së kandidati i pakënaqur me me vendimin e organit të punësimit, fillimisht,



duhet të ushtroj ankesë të brendshme tek Njësia Përgjegjëse e me tej, pas marrjes së vendimit të organit të punësimit apo në raste të heshtjes administrative, mund të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke respektuar afatet ligjore sipas nenit 127 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës rezulton së ankuesja me datë 12.09.2023, ka parashtruar ankesë të brendshme pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke kundërshtuar Vendimin me numër Nr.198/2023 të datës 08.09.2023, pra ende pa përfunduar afati ligjor për vendosje të ankesës nga ana e Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, ankuesja parashtron ankesë (me objekt të njëjtë) në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, nisur nga ky fakt, rrjedhë së ankesa me numër A.nr.1171/2023, e parashtruar me datë 18.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e parakohshme, Kolegji konstaton se ankesa e ankueses është e palejueshme ngase nuk ka shteruar procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit, ashtu siç përcaktohet në nenin 15 paragrafin 5 dhe 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 16 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe, dhe si e tillë është e palejueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1171/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.